

DOKUMENT POLITIKASH PËR VOTËN E DIASPORËS

**DOKUMENT POLITIKASH
PËR VOTËN E DIASPORËS**

Autor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përgatiti:

Dr. Heliona Miço, Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale,
Universiteti Epoka

Rishikimi ligjor:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Z. Emanuel Xhindi, Asistent Projektsh pranë Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky raport është hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të zbatimit

të projektit **“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike:**

Forcimi i rolit monitorues dhe kërkesës së llogarisë nga qytetarët nëpërmjet shoqërisë civile, medias dhe mbështetjes akademike”, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar në partneritet me Instituti i Studimeve Politike (ISP), Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përcjell domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të

Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10,

Tirana-Albania

PO BOX no.1752;

Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

PËRMBAJTJA

SHKURTIME	4
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. HYRJE	7
3. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	9
3.1 Mbështetja Ndërkombëtare për të Drejtën e Votës së Diasporës	9
3.2 Kuadri Ligjor Kombëtar	9
3.2.1 <i>Kushtetuta e RSH</i>	9
3.2.2 <i>Kodi Zgjedhor</i>	11
<i>Ndryshimet e Kodit Zgjedhor në vitin 2024</i>	11
a) Një përmasë e re e pjesëmarrjes demokratike.....	11
b) Roli udhëheqës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	12
c) Regjistrimi dhe verifikimi i zgjedhësve nga jashtë	12
ç) Lista e votuesve nga jashtë: një strukturë e re për përfaqësim.....	12
d) Logjistika e votimit: posta si mjet i përfaqësimit.....	12
dh) Dërgimi dhe kthimi i materialeve zgjedhore	13
e) Koha dhe vlefshmëria: një garanci për rregullin dhe barazinë.....	13
f) Numërimi i votave: transparencë dhe integritet institucional	13
g) E drejta për ankimim: mbrojtje procedurale për çdo qytetar	13
gj) Monitorimi teknik dhe ndërlidhja institucionale	13
3.2.3. <i>Ligji nr. 10/2025: Një fazë e dytë e konsolidimit të të drejtës së votës për diasporën shqiptare</i>	13
a) Luhatje në drejtim të aksesit në të drejtën e zgjedhjes – Ndryshimi i nenit 25 të Kodit Zgjedhor 14	
b) Mbështetje financiare dhe logjistike: nga barrë personale në përgjegjësi shtetërore	14
c) Saktësimi i procedurave të numërimit – Shtim i nenit 25/2 në Kodin Zgjedhor	14
d) Komision i posaçëm për votat nga jashtë.....	14
e) Standardizimi përmes akteve nënligjore: siguri dhe transparencë	15
f) Nga premtim në funksionalitet të qëndrueshëm.....	15
3.3 Kuadri Rregullator i Komisionit Qendror Zgjedhor	15
3.3.1 <i>Ecuria e procedurave për regjistrimin dhe votimin e zgjedhësve nga jashtë</i>	16
4. PRAKTIKAT E VENDEVE TË RAJONIT	22
4.1 Votimi i Diasporës në Serbi	22
4.2 Votimi i Diasporës në Kosovë	24
4.3 Analiza dhe krahasimi i praktikave	27
5. KONKLUZIONE	27
6. REKOMANDIME	30

SHKURTIME

BE	Bashkimi Evropian
DPGjC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
GNVJ	Grupi i Numërimit të Votave nga Jashtë
KANVVJ	Komisioni për Administrimin e Numërimit dhe Vlerësimit të Votave nga Jashtë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRZ	Komisioni Republikan Zgjedhor
KZ	Kodi Zgjedhor
KE	Këshilli i Evropës
PER	Platforma Elektronike e Regjistrimit
RKGJC	Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile
RSH	Republika e Shqipëria
UVR	Regjistri i Unifikuar i Votuesve
VNVJ	Vendi i Numërimit të Votave nga Jashtë

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Prej vitesh, diaspora shqiptare ka kërkuar të ushtrojë të drejtën e saj të votës, por sfidat dhe pengesat kanë bërë që ky proces të mbetet i pazgjidhur. Edhe pse e drejta për të votuar është e garantuar me ligj, mungesa e një mekanizmi të qartë dhe efektiv ka lënë mijëra shqiptarë jashtë kufijve të përjashtuar nga proceset zgjedhore.

Një nga problematikat kryesore ka qenë pikërisht mungesa e një sistemi funksional që do t'u mundësonte emigrantëve të votonin lehtësisht. Ndryshe nga shumë vende të tjera që kanë implementuar votimin elektronik ose me postë, Shqipëria deri në vitin 2024 nuk ka gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Ligji zgjedhor nuk ofronte udhëzime të detajuara mbi mënyrën se si mund të votonin qytetarët jashtë vendit, duke e lënë këtë çështje të hapur për diskutime të pafundme.

Por edhe kur është propozuar ndonjë zgjidhje, mungesa e vullnetit politik ka qenë një pengesë e vazhdueshme. Partitë politike shpesh e kanë trajtuar votën e diasporës si një faktor me ndikim të lartë elektoral dhe për pasojë mungesa e konsensusit ka vonuar çdo përpjekje për reformë. Përveç kësaj, edhe aspektet teknike e logjistike përbënin një sfidë serioze. Nuk ka patur një regjistër të saktë të votuesve në diasporë, duke e bërë të vështirë identifikimin dhe administrimin e procesit. Kërkesa për regjistrim paraprak shpesh shihej si një barrë shtesë për votuesit, duke ulur kështu mundësinë e pjesëmarrjes.

Përtej sfidave ligjore dhe teknike, një tjetër problem madhor është mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësisimit. Shumë shqiptarë që jetojnë jashtë nuk janë të informuar mbi të drejtat e tyre dhe mbi mundësitë e votimit. Përpjekjet për të zhvilluar fushata sensibilizuese kanë qenë të pakta, duke bërë që pjesëmarrja në procesin zgjedhor të mbetet minimale. Sidoqoftë, sipas statistikave të fundit, 246 mijë zgjedhës të regjistruar¹ janë një tregues pozitiv se procesi ka përparuar, dhe ndryshe nga vendet si Kosova, ku pjesëmarrja është shumë më e ulët në raport me popullsinë, Shqipëria ka shënuar një përmirësim të konsiderueshëm në lidhje me përfshirjen e diasporës. Kjo tregon se, megjithatë, jemi në një rrugë të mbarë për të mundësuar një pjesëmarrje më të madhe në zgjedhje, një sukses që duhet vlerësuar.

Për më tepër, skepticizmi mbi ndershmërinë dhe transparencën e procesit zgjedhor e ka bërë situatën edhe më komplekse. Frika nga manipulimet dhe ndikimi politik ka bërë që shumë emigrantë të mos kenë besim nëse vota e tyre do të numërohet ndershmërisht.

Kjo situatë është bërë edhe më problematike, për shkak të argumenteve, shpeshherë edhe të mbështetura, të fshehtësisë së votës së diasporës.

Në thelb, procesi i votimit dhe i dërgimit të votës nga shqiptarët me banim të përhershëm jashtë Republikës së Shqipërisë, nuk ofron garancitë e nevojshme për të garantuar fshehtësinë e votës. Çdokush i cili poston zarfin e plotësuar, mund të fotografojë apo t'ia tregojë dikujt tjetër se për cilin subjekt politik dhe kandidat ka votuar².

¹ <https://kqz.al/stats/>

² Nga diskutimet e zhvilluara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit me prokurorë të juridiksionit të përgjithshëm, një problem mjaft i mprehtë është konstatuar: duke qenë se fotografimi i votës dhe shkelja e rregullave të tjera të fshehtësisë së votës përbën veprë penale-neni 327 i Kodit Penal- konkretisht, cilës prokurori do t'i takojë kompetenca tokësore për ndjekjen penale?

Në një kohë kur diaspora luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë, përjashtimi i saj nga procesi politik është një kontradiktë e një tranzicioni të gjatë të demokracisë në vendit tonë që tashmë është jetësuar në këto zgjedhje parlamentare. Krijimi i një mekanizmi të besueshëm dhe transparent për votën e diasporës nuk është vetëm një nevojë ligjore, por edhe një detyrim moral e demokratik ndaj qindra mijëra shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit dhe që dëshirojnë të jenë pjesë e vendimmarrjes për të ardhmen e vendit të tyre.

Në këtë kontekst, rekomandohen disa hapa për të përmirësuar sistemin dhe për të mundësuar pjesëmarrjen e plotë të diasporës në zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë:

1. **Harmonizimi i Afateve për Ankimin Gjyqësor:** Duhet të sigurohet më shumë kohë për zgjedhësit që të regjistrojnë kërkesat e tyre dhe të harmonizohen afatet me proceset administrative, duke ulur mundësinë për vonesa dhe pengesa në pjesëmarrjen e diasporës. Gjithashtu, duhet të krijohet një sistem mbështetjeje dhe informacioni më i gjerë për diasporën për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe për të siguruar transparencën.
2. **Rishikimi i Strukturës së Komisionit për Votat nga Jashtë:** Struktura e komisionit duhet të përmirësohet për të garantuar një përfaqësim të balancuar të partive politike. Përfshirja e aktorëve të tjerë politikë është kyçe për forcimin e besimit të qytetarëve dhe transparencën në administrimin e procesit zgjedhor.
3. **Koordinimi i Akteve Ligjore dhe Nënligjore:** Duhet të rregullohen aktet rregullatore të KQZ për të harmonizuar afatet e regjistrimit me ato të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Kjo do të ndihmojë në sigurinë e një procesi më të qartë për zgjedhësit dhe administratën zgjedhore.
4. **Harmonizimi i Orarit të Votimit dhe Dërgimit të Dokumentacionit:** Orari i mbylljes së qendrave të votimit duhet të përputhet me afatin për dërgimin e dokumentacionit zgjedhor për të siguruar një proces zgjedhor të saktë dhe të paanshëm. Kjo do të kontribuojë në një proces më të qartë dhe më efikas, duke shmangur kontradiktat që mund të dëmtojnë besueshmërinë e zgjedhjeve.
5. **Përmirësimi i Kuptimit të Procedurave të Votimit nga Jashtë:** Është e nevojshme që të gjithë aktorët e përfshirë të kenë një kuptim të qartë të termave dhe procedurave që lidhen me kutitë e votimit nga jashtë dhe dokumentacionin zgjedhor. Kjo do të zvogëlojë mundësitë për pasaktësi dhe do të mundësojë një administrim më të efektshëm të procesit zgjedhor, duke ruajtur integritetin dhe transparencën e tij.

Këto rekomandime kanë si qëllim të sigurojnë një proces zgjedhor më të drejtë, të sigurt dhe të përfshirës për shqiptarët që jetojnë jashtë vendit, duke kontribuar në një demokraci më të fortë dhe të qëndrueshme.

2. HYRJE

Sipas vlerësimeve të tërthorta të INSTAT-it, numri i diasporës në vitin 2020 llogaritet të jetë rreth 1.7 milionë shtetas jashtë vendit ose rreth 37 % e shtetasve shqiptarë (*shih Diaspora e Shqipërisë në shifra, Instat, 2020*)³. Sipas të dhënave, nga këta 1.7 milionë shtetas, një pjesë e konsiderueshme, që përfshin 14% të zgjedhësve me të drejtë vote (mbi 18 vjeç), pritet të votojnë, duke e bërë këtë një përparim të rëndësishëm në përfshirjen e diasporës. Ata kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik e shoqëror, por për shumë vite janë përjashtuar nga e drejta për të ndikuar në politikëbërjen përmes votës.

Sanksionimi i votës së diasporës shqiptare është rezultat i një procesi të gjatë të nxitur nga rekomandimet ndërkombëtare, kërkesat e komunitetit të emigrantëve dhe zhvillimet e brendshme politike në Shqipëri. Përfshirja e emigrantëve në zgjedhje është perceptuar dhe raportuar mediatikisht se ndodhte në mënyrë të tërthortë, përmes transportimit të organizuar nga partitë politike, çka linte hapësira për manipulim dhe shitblerje të votës. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 38/2022 konstatoi shprehimisht se e drejta e votës për emigrantët ishte cenuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe se ekzistonte një boshllëk ligjor. Po ashtu, Vendimi nr. 28/2021 i Gjykatës Kushtetuese e shpalli të papajtueshëm me Kushtetutën nenin 163 të Kodit Zgjedhor që cenonte të drejtën e votës për shqiptarët jashtë vendit. Gjykata vëren se roli i diasporës shqiptare për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë është i rëndësishëm në shumë aspekte dhe është pranuar si i tillë edhe nga pushteti ligjvënës dhe ekzekutiv, përmes hartimit të strategjive specifike, ligjeve dhe masave të tjera⁴.

Dokumentet e OSBE/ODIHR kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, duke nxjerrë në pah mangësitë e mëparshme dhe duke rekomanduar përfshirjen e votuesve jashtë vendit. OSBE/ODIHR ka theksuar në mënyrë të drejtpërdrejtë se mungesa e votimit nga jashtë vendit përbën një kufizim të panevojshëm të të drejtës së votës.

Në raportin përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit 2021, OSBE/ODIHR theksoi rëndësinë e përfshirjes së diasporës në procesin zgjedhor dhe rekomandoi që autoritetet të ndërmarrin hapa konkretë për të mundësuar votimin nga jashtë, duke theksuar nevojën për zbatimin e Kodit Zgjedhor.

Në kuadër të Tryezës së Reformës Zgjedhore të vitit 2020⁵, u vendos si prioritet përfshirja e votuesve nga jashtë. Amendimet në Kodin Zgjedhor (Ligji nr. 101/2020) hapën rrugën për përpilimin e rregulloreve teknike që do të mundësonin regjistrimin dhe votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Vitet e fundit kanë shënuar një sensibilizim të jashtëzakonshëm të opinionit publik dhe të grupeve të interesit për këtë çështje. Kjo ka rezultuar në mbështetje masive të një nisme legislative të qytetarëve, e cila u miratua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 62, datë

³ OSBE. (2021). REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZGJEDHJET PARLAMENTARE 25 prill 2021. Misioni i Kufizuar i ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Raporti Përfundimtar. <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>.

⁴ Vendimi nr. 38, datë 09.12.2022 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

⁵ <https://www.eurospeak.al/news/speciale/mbi-amendimet-e-reformes-zgjedhore-te-vitit-/>.

20.06.2024⁶. Kjo nismë është propozuar nga Lëvizja “Shqipëria Bëhet”. Për më tepër, diaspora shqiptare, përmes organizatave dhe peticioneve, kërkoi të drejtën për të votuar nga vendet ku jetojnë. Platforma si “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” kanë qenë aktive në lobimin politik dhe në ndërtimin e konsensusit publik për të mundësuar ligjërisht votimin e shqiptarëve në diasporë. Kjo iniciativë nuk është e paprecedent, por ndjek modelet që kanë aplikuar prej vitesh vendet fqinje në rajon.

Gjithashtu, Shqipëria si vend kandidat për në BE ka për detyrë të përmirësojë standardet zgjedhore në përputhje me praktikën më të mirë evropiane. Raportet e Komisionit Evropian mbi Shqipërinë kanë përmendur mungesën e mekanizmave për votën e diasporës si një mangësi në pjesëmarrjen demokratike.

Këto hapa kanë nxitur diskutime dhe reforma në Shqipëri, duke çuar në përpjekje për të krijuar mekanizma ligjorë dhe teknikë që lejojnë pjesëmarrjen e diasporës në zgjedhje.

Sa më sipër, qëllimi i dokumentit të politikave është të paraqesë një analizë të hollësishme dhe një kornizë të qartë për zbatimin e të drejtës për të votuar të diasporës shqiptare, duke pasur parasysh kuadrin ligjor dhe sfidat e ndryshme që mund të lindin gjatë procesit. Dokumenti përqendrohet në mënyrën e implementimit të votës për diasporën dhe adresimin e çështjeve ligjore, teknike dhe logjistike të përfshira, duke pasur në vëmendje të tij çështje si: *krijimi i mekanizmave efektivë dhe të sigurt për pjesëmarrjen e diasporës në procesin zgjedhor; masat për mbrojtjen e integritetit dhe transparencës së votës së diasporës; identifikimin e praktikave dhe procedurave për regjistrimin dhe verifikimin e votuesve të diasporës, etj.*

Kjo është një përpjekje për të krijuar një sistem të drejtë, efikas dhe transparent, i cili do të mundësojë që diaspora shqiptare të ushtrojë të drejtën e votës në zgjedhje, duke kontribuar në forcimin e demokracisë dhe përfshirjes qytetare në vendimmarrjen politike.

⁶ Vendimi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Nr. 62, datë 20.06.2024, “Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve, për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

3. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

3.1 Mbështetja Ndërkombëtare për të Drejtën e Votës së Diasporës

Ndërkombëtarisht, mbështetja për të drejtën e votës për diasporën është e dukshme përmes rekomandimeve dhe akteve ligjore të ndryshme të Këshillit të Evropës (KE). Rekomandimi 951 (1982) adreson të drejtat e votës për shtetasit e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës që jetojnë jashtë shtetit të tyre. Rekomandimi thekson nevojën për reforma që do t'u mundësojnë shtetasve të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës të ushtrojnë të drejtat e tyre politike, veçanërisht në kontekstin e zgjedhjeve dhe referendumeve, pa marrë parasysh vendbanimin e tyre në shtetet anëtare⁷.

Rezoluta 1459 (2005) e Asamblese Parlamentare të Këshillit të Evropës “Heqja e kufizimeve mbi të drejtën e votës” kërkon që shtetet anëtare të rishikojnë dhe eliminojnë kufizimet e panevojshme të të drejtave zgjedhore, duke siguruar një qasje të barabartë dhe pa diskriminim për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh origjinën etnike, statusin shëndetësor, ushtarak apo penal. Përveç kësaj, dokumenti i rekomandon shtetet të mundësojnë pjesëmarrjen e diasporës përmes votimit me postë, konsullor ose elektronik, dhe të mbrojnë të drejtat e grupeve të cënueshme si të moshuarit dhe të burgosurit. Komisioni i Venecias ka identifikuar tri grupe shtetasish jashtë vendit që mund të kenë vështirësi në ushtrimin e të drejtës së votës, përfshirë ata që janë jashtë për arsye personale, akademike ose profesionale, dhe ata që jetojnë për një periudhë më të gjatë jashtë vendit dhe mund të kenë dy shtetësi. Kjo ka shkaktuar debate mbi statusin e diasporës dhe mundësinë e përfshirjes së saj në zgjedhje⁸.

Në praktikë, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë adoptuar mënyra të ndryshme për të mundësuar të drejtën e votës për qytetarët që jetojnë jashtë. Zgjedhjet kombëtare janë më të lehta për t'u hapur për qytetarët që jetojnë jashtë, ndërsa zgjedhjet lokale zakonisht mbeten të mbyllura për ta. Shumica e shteteve e konsiderojnë të ligjshme kërkesën për regjistrimin e votuesve jashtë vendit, edhe nëse regjistrimi është automatik për ata që jetojnë brenda vendit. Megjithatë, ndonëse disa shtete mund të justifikojnë detyrimin për të votuar në ambasada ose konsullata, kjo mund të kufizojë të drejtat e votuesve, për shkak të mundësive të kufizuara dhe të besueshmërisë së votimit fizik, si votimi me postë, prokurë ose elektronik.

3.2 Kuadri Ligjor Kombëtar

3.2.1 Kushtetuta e RSH

Në themelin e çdo demokracie qëndron e drejta e qytetarëve për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e garanton këtë të drejtë në mënyrë të qartë, në *nenin 45* duke përcaktuar se çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 18 vjeç, përfshirë edhe ata që e

⁷ Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rekomandimi 951 (1982), “E drejta për të votuar e shtetasve në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës”, 2 tetor 1982. <https://pace.coe.int/en/files/14985/html>.

⁸ Venice Commission and Council of Europe. (2011). REPORT ON OUT-OF-COUNTRY VOTING Adopted by the Council for Democratic Elections at its 37th meeting (Venice, 16 June 2011) and by the Venice Commission at its 87th plenary session (Venice, 17-18 June 2011) on the basis of comments by Ms. Josette DURRIEU (Expert, France) Mr. László TRÓCSÁNYI (Substitute member, Hungary).

arrijnë këtë moshë ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën e votës, pavarësisht se ku ndodhet.⁹ Nga ana tjetër, e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve. Në këtë këndvështrim, për vetë rëndësinë që merr kjo e drejtë në një shoqëri demokratike, kufizimet që i duhen bërë kësaj të drejte jo vetëm duhet të jenë të pakta, por ato duhen zbatuar brenda kufijve kushtetues. Kushtetuta e shoqëron këtë të drejtë me disa kufizime që aplikohen për kategori të caktuara të qytetarëve. Në aspektin e zgjedhësve, përjashtohen ata që janë shpallur të paafte mendërisht me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa për të drejtën për t'u zgjedhur, kufizime vlejnë për shtetasit e dënuar me burgim për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj, të miratuar me shumicën e cilësuar të Kuvendit. Për më tepër, ligji mund të vendosë kufizime të përkohshme edhe për të drejtën e votës së personave që vuajnë dënimin me heqje lirie ose që janë dënuar për shkelje të rënda të sigurisë publike. Është ligji për dekriminalizimin¹⁰ i cili ka konkretizuar disa kufizime të të drejtës për votë dhe kandidim, që lidhen me personat që janë dënuar me burgim për veprime penale të caktuara (p.sh., vepra penale që prekin sigurinë kombëtare, korrupsionin, apo që kanë lidhje me zgjedhjet e lira). Ata nuk mund të kandidojnë dhe të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut. Ky ndalim është i vlefshëm për të gjithë ata që kanë një dënim të formës së prerë dhe që kanë kryer veprime që lidhen me këto krime.

Për më tepër, Kushtetuta përcakton se vota duhet të jetë vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë, duke garantuar kështu standarde demokratike dhe mbrojtjen e vullnetit të lirë të qytetarëve në procesin zgjedhor. Në teori, kjo do të nënkuptonte se edhe shqiptarët që jetojnë jashtë duhet të kenë një mënyrë për të votuar. Por, ndonëse ligji themeltar e garanton këtë të drejtë, mekanizmat për ta zbatuar atë mungojnë. Pavarësisht këtij përcaktimi kushtetues, deri në vitin 2024,¹¹ mijëra shqiptarë të diasporës nuk kanë pasur mundësinë ta ushtrojnë këtë të drejtë në zgjedhjet parlamentare.

Parashikimi i votimit për shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit u bë pas ndryshimeve me ligjin nr. 101/2020 të Kodit Zgjedhor. Nëpërmjet ligjit nr. 101/2020¹² janë miratuar disa ndryshime dhe shtesa që lidhen me votimin nga jashtë shtetit. Ky proces administrohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), i cili është përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e kushteve që mundësojnë votimin për shqiptarët që jetojnë jashtë vendit. Sipas këtij ligji, votuesit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë Shqipërisë dhe janë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile mund të ushtrojnë të drejtën e votimit në zgjedhjet për qeverisjen qendrore. Votimi mund të bëhet manualisht ose nëpërmjet sistemit elektronik, duke garantuar integritetin e votës dhe fshehtësinë e saj. Votimi nga jashtë konsiderohet "i hapur" kur KQZ-ja fillon dërgimin e dokumentacionit të votimit dhe mbyllet në ditën e zgjedhjeve, në orën e caktuar nga Kodi Zgjedhor për mbylljen e votimit në qendrat e votimit brenda Shqipërisë. Pas mbylljes së procesit të votimit jashtë vendit, KQZ-ja nuk do të pranojë asnjë fletë votimi që mbërrin pas kësaj kohe

⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani, e ndryshuar

¹⁰ Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

¹¹ Ligji nr. 81/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

¹² Ligji nr. 101/2020, datë 23.07.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, <http://qbz.gov.al/eli/ligji/2020/07/23/101>.

dhe nuk do ta përfshijë atë në numërimin përfundimtar. KQZ-ja është e ngarkuar me administrimin e të gjithë komponentëve të votimit jashtë vendit, duke përfshirë procedurat, testimet paraprake të sistemeve elektronike, dhe verifikimin e tyre pas zgjedhjeve.

Gjithashtu, janë përcaktuar masa ligjore për monitorimin dhe mbikëqyrjen e këtij procesi, duke siguruar se të dhënat dhe materialet zgjedhore të administruara jashtë vendit janë të mbrojtura dhe pa ndërhyrje. Ky zhvillim është një hap i rëndësishëm për të garantuar pjesëmarrjen e shqiptarëve jashtë vendit në jetën politike të Shqipërisë dhe për të siguruar një proces zgjedhor të drejtë dhe të ndershëm për të gjithë qytetarët.

Megjithatë kjo kategori individësh u pengua të ushtronte të drejtën aktive të votës në zgjedhjet për Kuvendin që u zhvilluan më 25.04.2021 për shkak të mosmiratimit të akteve nënligjore prej KQZ-së sipas nenit 184 të Kodit Zgjedhor.

Është Gjykata Kushtetuese që me anë të vendimit nr. 38, datë 09.12.2022¹³ ka konstatuar se paqartësia e normave të Kodit Zgjedhor në drejtim të afatit, organit kompetent dhe parimeve në bazë të të cilave duhet të nxirren aktet nënligjore për këtë çështje jo vetëm cenon parimin e sigurisë juridike, por në fakt përbën boshllëk ligjor, që cenon të drejtën kushtetuese të votës. Sipas Gjykatës Kushtetuese, e drejta kushtetuese e votës së shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit për shkak të boshllëkut ligjor ka mbetur thjesht një parashikim deklarativ, i pazbatueshëm efektivisht në praktikë, duke mbetur në thelbin e saj iluzive. Gjykata vlerëson se i përket Kuvendit të plotësojë boshllëkun ligjor të lartpërmendur brenda një afati që në rastin konkret konsiderohet të caktohet një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Gjykata Kushtetuese me Vendimin Nr. 38/2022, jo vetëm ka konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese të votës së shtetasit shqiptar me banim jashtë vendit, por gjithashtu ka konstatuar boshllëk ligjor duke vendosur detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar.

3.2.2 Kodi Zgjedhor

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor në vitin 2024

Me miratimin e ligjit nr. 81/2024¹⁴, Shqipëria ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt forcimit të demokracisë përfaqësuese, duke njohur për herë të parë në mënyrë të strukturuar dhe funksionale të drejtën e votës për qytetarët e saj që jetojnë jashtë territorit. Ky ndryshim i shumëpritur në Kodin Zgjedhor i jep formë juridike një kërkesë të kahershme të diasporës shqiptare dhe një rekomandimi të përsëritur të institucioneve ndërkombëtare.

a) Një përmasë e re e pjesëmarrjes demokratike

Risia themelore e ligjit qëndron në faktin se për herë të parë vota e diasporës nuk mbetet më një premtim politik, por konkretizohet në procedura të qarta ligjore. Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, që ndodhet jashtë vendit në ditën e zgjedhjeve, fiton mundësinë të ushtrojë këtë të drejtë si

¹³ Vendimi nr. 38, datë 09.12.2022 I Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

¹⁴ Ligj nr. 81/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”

pjesë përbërëse e elektoratit. Kjo qasje e re e bën legjislacionin tonë më gjithëpërfshirës dhe më afër qytetarëve të tij të shpërndarë në botë.

b) Roli udhëheqës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Procesi i votimit nga jashtë nuk është thjesht një dërgim zarfi me postë – ai është një mekanizëm kompleks i organizuar dhe mbikëqyrur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja), i cili merr përsipër çdo komponent teknik e administrativ të këtij procesi. Nga ndërtimi i listave të votuesve e deri tek marrja, numërimi dhe shpallja e rezultateve, KQZ-ja është institucioni përgjegjës që garanton integritetin dhe barazinë e votës edhe për qytetarët jashtë kufijve.

Për herë të parë në mënyrë të plotë dhe të detajuar, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me Ligjin nr. 81/2024, i ngarkon KQZ një rol qendror dhe shumë dimensional në organizimin e votimit të shtetasve shqiptarë që ndodhen jashtë territorit të vendit.

Sipas nenit 24 të Kodit të ndryshuar, KQZ-ja është autoriteti përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e të gjithë procesit të votimit nga jashtë në zgjedhjet për Kuvendin. Kjo përfshin përgatitjen e kushteve teknike, operacionale dhe ligjore që mundësojnë një proces të rregullt dhe gjithëpërfshirës për zgjedhësit jashtë vendit. KQZ-ja merr përsipër jo vetëm menaxhimin teknik të procesit, por edhe ndërveprimin me çdo organ tjetër shtetëror apo privat që përfshihet në këtë administrim zgjedhor.

Vendosja e kësaj përgjegjësie mbështetet në parimin e barazisë së votës, ku çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në ditën e zgjedhjeve ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje nëpërmjet procedurave të veçanta të administruara nga KQZ-ja (neni 24, pika 2).

c) Regjistrimi dhe verifikimi i zgjedhësve nga jashtë

Në bazë të nenit 25, KQZ-ja është përgjegjëse për hartimin e listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë, duke garantuar një proces të hapur dhe të verifikueshëm. Regjistrimi kryhet përmes një platforme elektronike të zhvilluar dhe administruar nga vetë KQZ-ja (neni 25, pika 5), ku zgjedhësi paraqet dokumentacion që vërteton qëndrimin jashtë vendit. Këto të dhëna verifikohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, me qëllim regjistrimin e saktë të adresës së votuesit në një rubrikë të veçantë për votuesit nga jashtë (neni 25, pika 6).

ç) Lista e votuesve nga jashtë: një strukturë e re për përfaqësim

Krijimi i një liste të veçantë të zgjedhësve që votojnë nga jashtë përbën një nga risitë thelbësore të këtij ligji. Regjistrimi në këtë listë realizohet në mënyrë elektronike dhe kërkon dokumentim të qartë të qëndrimit jashtë vendit. Periudha e regjistrimit është e përcaktuar qartë – nis 120 ditë përpara zgjedhjeve dhe përfundon 60 ditë përpara tyre – duke siguruar kështu transparencë dhe kohë të mjaftueshme për përgatitje.

d) Logjistika e votimit: posta si mjet i përfaqësimit

Pas përfundimit të regjistrimit, çdo votues i regjistruar do të marrë paketën zgjedhore me postë, e cila përfshin fletën e votimit dhe udhëzimet përkatëse. Votuesi e plotëson dhe e kthen fletën me postë në adresën zyrtare të KQZ-së, duke mbajtur vetë shpenzimet e dërgimit – një element që, ndonëse mund të ketë kosto individuale, synon të shmangë ndërhyrjen e palëve të treta dhe të ruajë autonominë e votës.

dh) Dërgimi dhe kthimi i materialeve zgjedhore

Sipas neni 25/1, KQZ-ja organizon dhe garanton dërgimin e fletëve të votimit dhe materialeve të tjera informuese në adresat e zgjedhësve të regjistruar për votim nga jashtë. Këto fletë kanë një formë të ngjashme me ato që përdoren brenda vendit, por përmbajnë një element dallues për qëllime të identifikimit dhe ruajtjes së integritetit të procesit (neni 25/1, pika 2).

Përzgjedhja e ofruesit postar bëhet nga KQZ përmes procedurave të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik (neni 25/1, pika 3).

e) Koha dhe vlefshmëria: një garanci për rregullin dhe barazinë

Për të ruajtur koherencën kohore me zgjedhjet që zhvillohen brenda territorit, ligji parashikon që procesi i votimit nga jashtë të mbyllet në të njëjtën orë me përfundimin e votimit në Shqipëri. Vetëm ato fletë votimi që mbërrijnë ose kanë shënim hyrjeje në territorin shqiptar brenda këtij afati do të përfshihen në numërim.

f) Numërimi i votave: transparencë dhe integritet institucional

Votat e ardhura nga jashtë do të numërohen në ambientet e KQZ-së, duke u ndarë sipas zonës zgjedhore të fundit të banimit të zgjedhësit në Shqipëri. Numërimi nis paralelisht me kutitë e votimit brenda vendit dhe administrohet sipas një rregulloreje të miratuar nga organet përkatëse të KQZ-së, duke përfshirë edhe standardet për vëzhgim dhe dokumentim.

g) E drejta për ankimim: mbrojtje procedurale për çdo qytetar

Ligji u jep mundësi qytetarëve që nuk janë përfshirë në listën përfundimtare, ose që janë regjistruar gabimisht, të ankohen në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë, brenda një afati 7-ditor para zgjedhjeve. Gjykata e shqyrton dhe vendos në lidhje me kërkesën, brenda 24 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës, por jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve. Vendimi është i përjashtuar nga çdo taksë gjyqësore – një garanci e qartë për të drejtën e votës (neni 25, pika 8). Nëse gjykata vendos në favor të zgjedhësit deri 5 ditë para datës së zgjedhjeve, procedura e dërgimit të materialeve dhe vota e tij mund të mos mbërrijë në kohë për ditën e votimit, veçanërisht deri në orën 7 të mëngjesit të ditës së zgjedhjeve. Kjo e bën mekanizmin e ankimit joefektiv, pasi nuk mund të sigurohet që vota të realizohet në afatet e përcaktuara ligjërisht për të garantuar pjesëmarrjen në zgjedhje.

gj) Monitorimi teknik dhe ndërlidhja institucionale

Për të garantuar integritetin e procesit, ligji parashikon rolin e auditëve teknikë që do të ndjekin nga afër veprimet e KQZ-së. Për më tepër, përcaktohet edhe bashkëpunimi ndërmjet KQZ-së dhe Ministrisë së Brendshme për shkëmbimin e të dhënave, si dhe për çregjistrimin automatik nga lista e votuesve brenda vendit të atyre që votojnë nga jashtë, për të shmangur votimin e dyfishtë.

3.2.3. Ligji nr. 10/2025: Një fazë e dytë e konsolidimit të të drejtës së votës për diasporën shqiptare

Pas miratimit të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në vitin 2024, të cilat institucionalizuan për herë të parë votimin nga jashtë për zgjedhjet parlamentare, Ligji nr. 10/2025¹⁵ përfaqëson një fazë

¹⁵ Ligji nr. 10/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

thelbësore të thellimit teknik dhe zgjerimit normativ të kësaj të drejte. Ai synon të adresojë boshllëqet e mbetura dhe të forcojë funksionalitetin e këtij procesi përmes rregullimeve të detajuara procedurale, institucionale dhe teknike.

a) Luhatje në drejtim të aksesit në të drejtën e zgjedhjes – Ndryshimi i nenit 25 të Kodit Zgjedhor

Ndryshimet e vitit 2024 në Kodin Zgjedhor parashikuan që zgjedhësit jashtë Shqipërisë të mund të paraqesin kërkesë deri 7 ditë para zgjedhjeve në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë në rast se nuk janë regjistruar. Ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2025 ndryshojnë këtë afat në 30 ditë përpara zgjedhjeve, duke i dhënë zgjedhësit më pak kohë për të paraqitur ankesën. Gjithashtu, ato parashikojnë mundësinë e paraqitjes së ankesave përmes një platforme elektronike të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke e lehtësuar dhe e bërë më të aksesueshëm procesin për zgjedhësit jashtë vendit. Gjykata shqyrton dhe vendos brenda 48 orëve nga regjistrimi i kërkesës. Vendimi i saj ka efekt të drejtpërdrejtë në përditësimin e listës së votuesve nga jashtë, duke mundësuar një mekanizëm efektiv ankimimi që garanton realizimin e të drejtës për të votuar.¹⁶

b) Mbështetje financiare dhe logjistike: nga barrë personale në përgjegjësi shtetërore

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2025 zhvendosin përgjegjësinë për shpenzimet postare nga zgjedhësi tek shteti. Tani, është KQZ-ja që mbulon kostot për dërgimin dhe kthimin e fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore. Kjo masë eliminon një barrierë ekonomike që, në mungesë të mbështetjes institucionale, mund të çonte në përjashtim të heshtur të shumë votuesve të diasporës. Për më tepër, KQZ-ja është e detyruar të përzgjedhë ofrues postarë ndërkombëtarë me reputacion të lartë, duke përdorur procedura të përshpejtuara prokurimi, në mënyrë që të garantohet efikasiteti dhe siguria e procesit.

c) Saktësimi i procedurave të numërimit – Shtim i nenit 25/2 në Kodin Zgjedhor

Për herë të parë, përmes shtimit të nenit 25/2 në Kodin Zgjedhor, përshkruhet në mënyrë të detajuar procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave nga jashtë territorit të Shqipërisë. Fletët e votimit të mbërritura nga jashtë regjistrohen dhe ndahen sipas zonës zgjedhore të fundit të banimit të zgjedhësit, duke respektuar parimin e përfaqësimit territorial. Numërimi kryhet në vend të caktuar nga KQZ-ja dhe fillon njëkohësisht me numërimin e kutive të votimit brenda vendit, duke garantuar një kohëzgjatje të barabartë të procesit dhe shmangur çdo manipulim të mundshëm në momentet e fundit.

d) Komision i posaçëm për votat nga jashtë

Për administrimin e numërimit të votave të diasporës, ligji parashikon ngritjen e një komisioni të specializuar me pesë anëtarë: katër të propozuar në mënyrë të balancuar nga shumica dhe pakica parlamentare, dhe një sekretar të zgjedhur në bazë të konkurrimit të hapur, i cili duhet të ketë formim juridik. Kjo strukturë siguron kontroll të ndërsjellë politik, por edhe integritet profesional në proces. Megjithatë, kjo strukturë i jep dominim dy partive kryesore, duke krijuar një mundësi monopolizimi që nuk garanton përfshirjen e palëve të tjera dhe bie ndesh me rekomandimet e OSBE/ODIHR për depolitizimin e organeve të administratës zgjedhore në të gjitha nivelet, të cilat

¹⁶ Vendim nr. 129, datë 06.03.2025 i KLGJ, “Për miratimin e platformës elektronike për paraqitjen e kërkesave edhe online të zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. <https://klgj.al/media/0ish1b4o/vendim-nr-129-dat%C3%AB-06-03-2025-p%C3%ABr-miratimin-e-platform%C3%ABs-elektronike-p%C3%ABr-paraqitjen-e-k%C3%ABrkesave-edhe-online-t%C3%AB-zgjedh%C3%ABsve-q%C3%AB-votojn%C3%AB-nga-jasht%C3%AB-territorit-t%C3%AB-republik%C3%ABs-s%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB.pdf>

kërkojnë që proceset zgjedhore të jenë të drejta, të paanshme dhe të mbështetura në përfshirjen e të gjitha aktorëve politikë. Në rast se numri i votuesve nga jashtë tejkalon 80 mijë, Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet ka të drejtë të ngrejë komisione të tjera shtesë, me kusht që të mos cenohet uniteti i vlerësimit për çdo qark zgjedhor.

e) Standardizimi përmes akteve nënligjore: siguri dhe transparencë

Ligji u jep Rregullatorit dhe Komisionerit kompetencën për të miratuar aktet nënligjore që rregullojnë çdo aspekt teknik të procesit: nga dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim, formatet e numërimit, deri tek mënyra e vëzhgimit dhe shpalljes së rezultatit. Ky sistem normativ dytësor garanton që rregullat të jenë të qarta, të njëjta për të gjithë dhe të përputhshme me zhvillimet teknologjike dhe sfidat logjistike që shoqërojnë votimin nga jashtë.

f) Nga premtim në funksionalitet të qëndrueshëm

Në tërësinë e tij, ndryshimet e Kodit Zgjedhor të sanksionuara nëpërmjet ligjit nr. 10/2025 përfaqësojnë fazën e dytë të institucionalizimit të votës së diasporës, duke bërë të mundur kalimin nga një sistem simbolik të votës së diasporës, në një mekanizëm real, të besueshëm dhe të gjithëpërfshirës. Kjo paketë përforcuese e ligjit garanton jo vetëm rritje të aksesit dhe sigurisë për votuesit jashtë vendit, por edhe integritet më të lartë të procesit zgjedhor në tërësi.

3.3 Kuadri Rregullator i Komisionit Qendror Zgjedhor

Ndryshimet ligjore për procesin elektoral kanë për qëllim përmirësimin e procesit të votës për diasporën, duke lehtësuar burokracitë që shpesh krijojnë pengesa për pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje. Këto përmirësime synojnë të bëjnë procesin më të thjeshtë dhe më të aksesueshëm, duke mundësuar që më shumë shtetas shqiptarë jashtë vendit të realizojnë të drejtën e tyre të votës. Megjithatë, këto ndryshime, të reflektuara edhe nga kuadri rregullator i KQZ, synojnë të mos dëmtojnë integritetin e procesit zgjedhor, duke siguruar që votimi të mbetet i besueshëm dhe i paanshëm.

- a) Vendimi i Komisionit Rregullator KQZ nr. 10, datë 23.10.2024**, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, i ndryshuar me **Vendimin nr. 3, datë 24.01.2025** “Për një shtesë në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve” dhe **nr. 17, datë 10.03.2025**, të Komisionit Rregullator “Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, të ndryshuar”
- b) Vendimi i Komisionit Rregullator KQZ nr. 11, datë 01.11.2024**, “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”, i ndryshuar me **Vendimin nr. 8, datë 13.02.2025** të Komisionit Rregullator “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të republikës së shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”.
- c) Vendimi i Komisionit Rregullator KQZ nr. 13, datë 12.11.2024** “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”, i ndryshuar me **vendimin nr. 21**,

datë 20.03.2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 13, datë 12.11.2024 “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”.

- d) Vendimi i Komisionit Rregulator KQZ nr. 7, datë 14.02.2025** “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.5.2025”.
- e) Vendimi i Komisionit Rregulator KQZ nr. 22, datë 20.03.2025** “Për rregullat për administrimin, numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumentacionin përkatës si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë vendit”.
- f) Vendimi i Komisionit Rregulator KQZ nr. 23, datë 20.03.2025** “Për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

3.3.1 Ecuria e procedurave për regjistrimin dhe votimin e zgjedhësve nga jashtë

- A) Vendimi i Komisionit Rregulator KQZ nr. 10, datë 23.10.2024**, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

Vendimi nr. 10, datë 23.10.2025 parashikon një sërë rregullash të nevojshme për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Shqipërisë, përshkruan detajet e procedurës që duhet të ndjekë një shtetas shqiptar që dëshiron të regjistrohet për të votuar në zgjedhjet për Kuvendin, duke përfshirë disa faza dhe hapa të rëndësishëm. Me anë të këtij akti u mundësua që çdo shtetas shqiptar që ka të drejtën e votës dhe ndodhet jashtë Shqipërisë të ketë mundësi të barabarta për të votuar.

Shtetasit shqiptarë që duan të ushtrojnë të drejtën e votës nga jashtë duhet të regjistrohen në mënyrë vullnetarë në listën e zgjedhësve jashtë vendit. Ky regjistrim mund të realizohet përmes një platforme elektronike të quajtur Platforma Elektronike e Regjistrimit (PER), e cila është menaxhuar dhe mbajtur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Kjo platformë është e aksesueshme për çdo zgjedhës, falas dhe mund të përdoret në versionin desktop ose celular, pa kufizime në llojin e pajisjes që përdoret.

Regjistrimi për zgjedhësit që votojnë jashtë mund të realizohet duke krijuar një llogari personale në platformën PER. Pasi zgjedhësi të krijojë llogarinë, ai duhet të ngarkojë të dhënat e tij personale, si numri i identifikimit, datëlindja, vendlindja, një pamje të fytyrës për verifikimin biometrik (njohja e fytyrës) dhe një numër telefoni celular dhe/ose email. KQZ kontrollon përputhshmërinë e të dhënave me ato të regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), dhe nëse të dhënat përputhen, llogaria krijohet. Pasi të krijohet llogaria, zgjedhësit mund të ndjekin statusin e kërkesës së tyre dhe të marrin informacion dhe udhëzime rreth procedurës dhe kushteve të regjistrimit për votim nga jashtë.

Përsa i përket afateve, regjistrimi mund të bëhet nga 120 ditë përpara zgjedhjeve deri 68 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Ndërkohë, lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë publikohet 63 ditë para zgjedhjeve dhe mund të korigjohet brenda 24 orëve, para se të publikohet lista përfundimtare 60 ditë përpara zgjedhjeve. Kjo procedurë siguron që zgjedhësit të kenë mundësinë të aplikojnë

brenda një periudhe të caktuar dhe që KQZ të ketë kohë të mjaftueshme për përpunimin e kërkesave dhe përfshirjen e të dhënave në listën përfundimtare.

Në rast se zgjedhësi vëren ndonjë gabim ose mungesë në regjistrin e tij, ai mund të paraqesë ankim deri 30 ditë përpara zgjedhjeve. Kërkesat e ankimit shqyrtohen brenda 48 orëve, dhe në rast aprovimi, të dhënat përfshihen në listën përfundimtare. Ky proces i përshpejtuar dhe i organizuar ofron mundësinë që zgjedhësit të regjistrohen dhe të realizojnë të drejtën e tyre për të votuar në mënyrë të sigurt dhe të aksesueshme.

Përbërësit e Listës së Zgjedhësve që Votojnë nga Jashtë Vendit

Lista e zgjedhësve që votojnë jashtë Shqipërisë përbëhet nga shtetasit shqiptarë që janë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe kanë shprehur vullnetin për të votuar nga jashtë. Kjo listë është e përditësuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC). Ajo përmban informacionin personal të zgjedhësve, si numri i identifikimit, emri, adresa, dhe statusi i tyre si zgjedhës jashtë vendit. Për të finalizuar këtë listë parashikohet angazhimi i një sërë institucionesh shtetërore:

- KQZ-ja përcjell kërkesat e miratuara në DPGJC, e cila publikon listën brenda 24 orëve.
- Lista paraprake publikohet 63 ditë para zgjedhjeve dhe lista përfundimtare 60 ditë para zgjedhjeve.
- Zgjedhësit mund të korrigjojnë pasaktësitë në listë deri 63 ditë para zgjedhjeve.
- Lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit dërgohet për ruajtje në Arkivin Qendror të Shtetit.

Nëse ndodhin gabime në regjistrim, zgjedhësit mund të ankimojnë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm deri 30 ditë para zgjedhjeve. Kërkesat shqyrtohen brenda 48 orëve dhe, në rast se miratohen, të dhënat përfshihen në listën përfundimtare. Pas regjistrimit, zgjedhësit do të çregjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda Shqipërisë.

*Theksojmë që në lidhje me afatet e regjistrimit të zgjedhësve që votojnë nga jashtë, në nenin 25 pika 4 e Kodit Zgjedhor, thuhet se procesi i hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Ndërsa në Kreu II, pika 6 të vendimit nr. 10/2024 të KQZ-së, afati për paraqitjen e kërkesës për regjistrim fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve, por përfundon **68 ditë para zgjedhjeve**. Vendimi nr. 10/2024 i KQZ-së, nuk mund të parashikojë një afat të ndryshëm për një çështje që është tashmë e parashikuar në Kodin Zgjedhor. Kodi Zgjedhor, si një akt ligjor më i lartë, ka prioritet mbi aktet nënligjore dhe aktet rregullatore që dalin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ose autoritete të tjera.*

B) Vendimi i Komisionit Rregullator KQZ nr. 11, datë 01.11.2024, “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”, i ndryshuar.

Vendimi ka për qëllim të përmirësojë procesin e regjistrimit të zgjedhësve shqiptarë që votojnë jashtë Shqipërisë, duke mundësuar paraqitjen e dokumenteve të nevojshme për verifikimin e qëndrimit të tyre jashtë vendit. Zgjedhësit duhet të ngarkojnë dokumente si: dokument pronësie, kontrata qiraje, dokumente bankare, ose leje drejtimi, për të vërtetuar adresën e banimit. Po ashtu, janë parashikuar mundësitë që më shumë se 6 persona mund të regjistrohen në të njëjtën adresë, nëse justifikohen ligjërisht.

Në ndryshimet e miratuara në shkurt 2025, është lehtësuar dorëzimi i dokumenteve nga anëtarët e familjes ose persona që jetojnë në të njëjtën adresë. Dokumentet që vërtetojnë adresën mund të ngarkohen edhe nga individë të tjerë që ndodhen në të njëjtën adresë, me kusht që personi që figuron në dokument të konfirmojë lidhjen familjare me aplikuesin.

Ky vendim synon përmirësimin e procesit të regjistrimit për zgjedhësit jashtë vendit, duke bërë të mundur verifikimin më të thjeshtë dhe fleksibël të qëndrimit dhe duke siguruar lidhjen e duhur familjare për aplikantët që jetojnë së bashku.

C) Vendimi i Komisionit Rregullator KQZ nr. 13, datë 12.11.2024 “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”, i ndryshuar

Vendimi nr. 13/2014 i Komisionit Rregullator ka për qëllim të përcaktojë procedurat për regjistrimin dhe votimin e zgjedhësve shqiptarë jashtë vendit, duke siguruar mundësi të barabarta për të ushtruar të drejtën e votës. Zgjedhësit jashtë vendit duhet të regjistrohen në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER), ku duhet të ngarkojnë dokumente identifikimi dhe të dhëna personale.

Fleta e votimit që përdoret për diasporën është e njëjtë me atë të përdorur brenda Shqipërisë, por ka një dallim që e identifikon si për përdorim jashtë vendit. Fletët e votimit përgatiten për çdo zonë zgjedhore, me një rezervë prej 2%. Procesi i votimit për diasporën fillon me dërgimin e dokumentacionit zgjedhor dhe përfundon në orën 19:00 të ditës së zgjedhjeve, sipas orarit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.

Dokumentacioni i dërguar përfshin fletën e votimit, zarfin për fletën e votimit, material udhëzues për plotësimin e fletës, dhe zarfin e jashtëm me Kodin Unik të regjistrimit të zgjedhësit. Zgjedhësit plotësojnë fletën e votimit dhe e dërgojnë atë në adresën e KQZ-së përmes një shërbimi postar që mundëson gjurmimin e dërgesës. Dërgimi duhet të bëhet brenda afatit të caktuar, për t'u siguruar që dokumenti mbërrin në Shqipëri deri në orën 19:00 të ditës së zgjedhjeve.

Lidhur me këtë moment konstatohet mungesa e qartësisë ligjore në lidhje me afatin e dërgimit të zarfit me fletën e votimit. Vendimi i Rregullatorit nr. 13/2024 përcakton që zgjedhësi duhet të dërgojë dokumentacionin zgjedhor për në KQZ brenda një afati që mundëson mbërritjen e tij në Shqipëri para orës 19:00 të ditës së zgjedhjeve. Kjo dispozitë e paqartë nuk specifikon se cili është afati i saktë për dërgimin e zarfit me fletën e votimit (p.sh., data dhe ora e fundit që mund të dërgohet materialet), duke cënuar parimin e sigurisë juridike. Mungesa e një udhëzimi të qartë dhe të detajuar mund të çojë në përjashtimin e votuesve që kanë dërguar dokumentet në afate të pranueshme, por që kanë pasur vonesa të papritura gjatë procesit të dërgesës.

Vendimi nr. 13/2024 parashikon një procedurë të detajuar dhe të qartë për administrimin e dokumentacionit zgjedhor të dërguar nga zgjedhësit jashtë vendit. Ky proces është ndarë në disa faza të rëndësishme për të siguruar ruajtjen, administrimin dhe vlerësimin e dokumenteve zgjedhore që mbërrijnë nga diaspora.

Operatorët e shërbimit postar janë përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit zgjedhor në ambiente të sigurt dhe të monitoruara me kamera, për të siguruar transparencë dhe përputhshmëri me legjislacionin. Regjistrimet e monitorimit ruhen deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare dhe mund të ofrohen për parti të politike.

Shërbimi postar mban regjistra të detajuar për çdo dërgesë, duke përfshirë emrin e dërguesit, shtetin dhe datën e mbërritjes. KQZ merr dokumentacionin dy herë brenda 24 orëve dhe ruan në një ambient të sigurt dhe të monitoruar, të paaksesueshëm për individët e paautorizuar, dhe mund të vëzhgohet nga vëzhgues të regjistruar.

Dokumentet futen në kutinë e votimit nga jashtë, e cila mbyllet me vula sigurie në prani të përfaqësuesve të partive politike dhe shoqërisë civile për transparencë. Pas mbylljes, procesverbalet e kutive ruhen nga KQZ. Në rast pasaktësish apo mungesash në dokumente, si mungesa e zarfit me Kodin Unik, KQZ krijon një procesverbal dhe depoziton dokumentet në një kuti të posaçme. KQZ siguron ruajtjen e kutive deri në fillimin e numërimit, dhe çdo dokument që mbërrin pas mbylljes depozitohet në kutinë rezervë.

Vendimi i Komisionit Rregullator KQZ nr. 13, datë 12.11.2024 ka ndryshuar nëpërmjet vendimit nr. 21, datë 20.03.2025. Ndryshimet janë të përqendruara kryesisht në proceset dhe procedurat zgjedhore të zgjedhësve jashtë vendit lidhur me:

- a) Përditësimin i procedurave të administratës zgjedhore;
- b) Përfshirjen e një kodi unik për secilin zgjedhës;
- c) Përmirësimin e procedurës për mbikëqyrjen e fushatës zgjedhore;
- d) Rregullat për administrimin e zarfit që përmban kodin unik;
- e) Ruajtjen e Dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë;
- f) Dokumentacion zgjedhor të depozituar pas orës 19:00.

Këto ndryshime kanë për qëllim përmirësimin e transparencës, efikasitetit dhe ndershmërisë në procesin zgjedhor, duke e bërë më të lehtë për zgjedhësit të ushtrojnë të drejtën e votës dhe për autoritetet të mbikëqyrin procesin.

Pavarësisht kësaj, momente të caktuara kanë nevojë për saktësim juridik, një nga të cilat është përputhshmëria e orarit të votimit. Kodi Zgjedhor përcakton një orar të qartë për mbylljen e qendrave të votimit, duke parashikuar mbylljen në orën 19:00 të ditës së zgjedhjeve. Ndërkohë, në Vendimin nr. 13/2024, ndryshimi i pikës 6 të Kreut III.3 flet për një "afati të rekomanduar" të përcaktuar në materialin udhëzues që dërgohet nga KQZ. Ky mund të jetë një burim paqartësie dhe kontradikte mes orarit të caktuar për mbylljen e qendrave të votimit në Kodin Zgjedhor dhe orarit për dërgimin e dokumentacionit zgjedhor. Mungesa e saktësimin në vendimin nr. 13, të rregullatorit mund të ndikojë në procesin e votimit, duke krijuar mundësi për mos përputhje dhe vonesa që mund të cenojnë integritetin e procesit zgjedhor.

Në vendimin nr. 13 të Rregullatorit, pika 16 e ndryshuar parashikon se, në rast se shërbimi postar depoziton dokumentacion zgjedhor pas orës 19:00 të ditës së votimit, por jo më vonë se 24 orë pas këtij momenti, KQZ-ja duhet ta regjistrojë këtë dokumentacion dhe ta depozitojë në një kuti votimi nga jashtë rezervë përkatëse. Megjithatë, vendimi nuk sqaron se çfarë do të ndodhë me materialet që ndodhen në kutinë rezervë dhe si do të trajtohen ato pas depozitimit, përveç rasteve kur pas hapjes së zarfit të shërbimit postar rezulton se mungon zarfi që përmban Kodin Unik të zgjedhësit, ose në zarfin që duhet të ishte vendosur/ngjitur Kodi Unik, mungon ky i fundit.

Përdorimi i termave si "kuti e posaçme rezervë", që nuk janë përmendur më parë në Kodin Zgjedhor, krijojnë paqartësi ligjore dhe ka mungesë të shpjegimit të procedurës pas depozitimit të këtyre kutive. Kjo mund të çojë në vështirësi lidhur me mënyrën e trajtimit të dokumenteve që arrijnë pas orës 19:00, duke lënë hapësirë për pasiguri dhe interpretim të gabuar në lidhje me vlefshmërinë e materialeve zgjedhore.

D) Vendimi i Komisionit Rregullator KQZ nr. 7, datë 14.02.2025 “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.5.2025”

Me anë të këtij vendimi janë miratuar karakteristikat teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Shqipërisë për zgjedhjet e Kuvendit që do të mbahen më 11 maj 2025. Vendimi i miratuar përcakton specifikimet dhe dimensionet e fletës së votimit, si dhe elementët e sigurisë që do të përdoren në procesin zgjedhor. Specifikimet përfshijnë:

1. Përmasat: Fleta e votimit do të ketë gjerësi 297 mm dhe gjatësi 420 mm.
2. Materiali: Letër methurje (watermark), 90g/m², me fibra karboni ultraviolett, mikroprintime dhe shënime të dukshme vetëm me rreze ultraviolett.
3. Ngjyra dhe dizajni: Ngjyrë e veçantë dhe shirita vertikale në pjesën e pasme; përmban stemën e Republikës së Shqipërisë dhe logon e KQZ.
4. Elementë të veçantë: Kod QR dhe shënime identifikues për qarkun dhe zgjedhësin.

E) Vendimi i Komisionit Rregullator KQZ nr. 22, datë 20.03.2025 “Për rregullat për administrimin, numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumentacionin përkatës si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë vendit”

Vendimi nr. 22/2025 i Komisionit Rregullator ka për qëllim rregullimin e procedurave për administrimin, numërimin dhe vlerësimin e votave nga zgjedhësit jashtë territorit të Shqipërisë. Ky vendim mbështetet në parime të ligjshmërisë, transparencës, paanësisë dhe sigurisë së votës, duke siguruar një proces të drejtë dhe të sigurt.

Vendimi përcakton procedura të qarta për numërimin dhe vlerësimin e votave, duke përfshirë caktimin e vendit të numërimit të votave nga jashtë (VNVJ), personelin përgjegjës dhe dërgimin e dokumentacionit zgjedhor në VNVJ. Ky proces përfshin monitorimin me kamera dhe praninë e përfaqësuesve të medias, vëzhguesve dhe kandidatëve në VNVJ për sigurinë dhe transparencën e procesit.

Për administrimin e votave, është krijuar Komisioni për Administrimin e Numërimit dhe Vlerësimit të Votave nga Jashtë (KANVVJ), i cili ka përgjegjësi për numërimin dhe vlerësimin e votave. Kur numri i zgjedhësve jashtë vendit kalon 80,000, krijohen komisione shtesë, por për çdo qark, numërimi bëhet nga një komision i vetëm. Grupi i Numërimit të Votave nga Jashtë (GNVJ) për çdo zonë zgjedhore është përgjegjës për numërimin e votave për subjektet zgjedhore dhe kandidatët, duke siguruar që çdo hap të jetë i kontrolluar dhe i dokumentuar.

Në lidhje me transportimin e dokumenteve zgjedhore, ato dërgohen me shoqërimin e Policisë së Shtetit dhe dorëzohen nëpërmjet një procesverbali të nënshkruar nga përfaqësuesit e KQZ dhe KANVVJ. Nëse ka pasaktësi me vulat e kutive të votimit, ato kalojnë në hetim administrativ.

Pas numërimit, kutitë e votimit janë të mbyllura me vula sigurie dhe të dhënat regjistrohen në procesverbalet përkatëse, të cilat miratohen dhe dërgohen në KQZ. Votat e vlefshme dhe të pavlefshme përcaktohen sipas kriterëve të saktësuar, dhe çdo subjekt zgjedhor dhe organizata vëzhguese kanë të drejtën të dërgojnë vëzhgues për të monitoruar procesin dhe të kërkojnë kopje të tabelës së rezultatit.

Megjithatë, konstatohet paqartësi ligjore në kuadër të terminologjisë, procedurave dhe dokumentacionit zgjedhor të rregulluar nëpërmjet vendimeve të Rregullatorit.

Ka kontradikta midis pikës 16 të ndarjes III.4 të Kreut III të Vendimit nr. 13, datë 12.11.2024, të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 22, datë 20.03.2025, në lidhje me përdorimin e kutisë rezervë për votimin nga jashtë dhe dokumentacionin zgjedhor që futet në këtë kuti. Po ashtu, ka paqartësi në identifikimin e qartë të dokumenteve zgjedhore që nuk i nënshtrohen vlerësimit.

Për herë të parë, termat si "kuti e posaçme e votimit nga jashtë", "kuti rezervë e votimit nga jashtë", dhe "kuti e posaçme rezervë e votimit nga jashtë" u përdorën në Vendimin nr. 13, datë 12.11.2024, por pa një sqarim të plotë të funksionit dhe kuptimit të tyre në terminologjinë juridike. Kjo pasaktësi u sqarua më vonë në Vendimin nr. 22, datë 20.03.2025, ku u dha përkufizimi i termave dhe roli i tyre në procesin zgjedhor.

Për më shumë, pika 16 e ndarjes III.4 të Kreut III të Vendimit nr. 13 parashikon që, nëse shërbimi postar dërgon dokumentacion zgjedhor në KQZ pas orës 19:00 të ditës së zgjedhjeve, por brenda 24 orëve nga ky moment, KQZ duhet ta regjistrojë dhe të depozitojë këtë dokumentacion në një kuti votimi nga jashtë rezervë përkatëse. Nga ana tjetër, Vendimi nr. 22 specifikon një trajtim të ndryshëm për dokumentacionin që që ruhet në kutinë rezervë të votimit nga jashtë. Sipas këtij vendimi, dokumentacioni që mbërrin pas mbylljes së kutisë së votimit nga jashtë, deri në orën 19:00 të ditës së zgjedhjeve, depozitohet në një kuti rezervë dhe regjistrohet nga KQZ sipas rregullave të përcaktuara, por gjithashtu i nënshtrohet procesit të vlerësimit të dokumentacionit në përputhje me procedurat e miratuara.

F) Vendimi i Komisionit Rregullator KQZ nr. 23, datë 20.03.2025 “Për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

Me anë të këtij vendimi bëhet e mundur përfshirja për herë të parë e votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit për zgjedhjet parlamentare të datës 11 Maj 2025.

4. PRAKTIKAT E VENDEVE TË RAJONIT

4.1 Votimi i Diasporës në Serbi

Në Serbi aplikohet sistemi proporcional, ku 250 deputetët e saj zgjidhen përmes votimit me lista të mbyllura kandidatësh.¹⁷ Serbia ka ratifikuar dhe është shtet palë i një sërë instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale që lidhen me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.¹⁸ Lidhur me parashikimet ligjore përsa i përket zgjedhjeve parlamentare, në krye të piramidës së akteve normative qëndron Kushtetuta (2006), e ndjekur nga Ligji për “Zgjedhjen e Deputetëve” (2002), ku në 2022 kanë ndodhur një sërë ndryshimesh duke përfshirë edhe rekomandimet e OSBE/ODHIR lidhur me administrimin e zgjedhjeve, financimin e fushatës si dhe zgjedhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Kuadri ligjor ka mbetur i pandryshuar që nga 2022, me përjashtim të dy ligjeve të reja, konkretisht Ligji për “Median Elektronike” dhe Ligji për “Informacionin Publik dhe Median” të miratuara në tetor 2023.

Ndërkohë që, votimi i diasporës në Serbi funksionon përmes një procesi të organizuar nga shteti serb, i cili u mundëson shtetasve serbë që jetojnë jashtë vendit të marrin pjesë në zgjedhje. Përsa i përket rregullave dhe procedurave për votimin e diasporës në Serbi, të drejtën për të votuar, e kanë shtetasit serbë që jetojnë jashtë, të cilët mund të votojnë në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, por jo në zgjedhjet lokale.

Komisioni Republikian Zgjedhor (KRZ) është organi kompetent për caktimin e qendrave të votimit, brenda dhe jashtë vendit, sipas kërkesave të Ministrisë për Punët e Jashtme për qendrat e votimit jashtë shtetit.¹⁹ Caktimi i qendrave të votimit, bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së votimit, me qëllim që qytetarët që votojnë të kenë një informacion të qartë dhe të mjaftueshëm për vendndodhjen. Neni 86 i ligjit për “Zgjedhjen e Deputeteve” parashikon se janë misionet diplomatike dhe konsullore ato që i dërgojnë ftesën për të votuar, qytetarëve që jetojnë dhe votojnë jashtë vendit. Sipas legjislacionit vendas, votimi zhvillohet *vetëm në përfaqësitë diplomatike/konsullore* të Serbisë jashtë vendit dhe nuk aplikohen format e tjera të votimit siç mund të jetë ai me postë ose votimi elektronik.


Zgjedhjet e fundit parlamentare në Serbi, u mbajtën në 17 dhjetor 2023, ku sipas KRZ kishte rreth 39,270 votues të regjistruar nga jashtë. Këto zgjedhje ishin mjaft të kontestuara në vend, ku vetëm një ditë më pas Koalicioni “Serbia kundër Dhunës” nisi protestat në Beograd, duke kërkuar përsëritjen e zgjedhjeve lokale si dhe zgjedhje të parakohshme parlamentare për shkak të dyshimeve lidhur me presionin mbi votuesit, blerjen e votave si dhe transportimin e organizuar me autobus të votuesve nga brenda dhe nga jashtë Serbisë. Njëherësh ky koalicion kërkoi akses të menjëhershëm në Regjistrin të Unifikuar të Votuesve (UVR) për të verifikuar akuzat që lidheshin me lëvizjen e organizuar të votuesve.

¹⁷ <http://www.parlament.gov.rs/national-assembly/role-and-mode-of-operation/elections-and-electoral-system.502.html>

¹⁸ Including the 1966 International Covenant on Civil and Political Rights, 1979 Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination Against Women, 1965 International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination, 2003 Convention against Corruption, 2006 Convention on the Rights of Persons with Disabilities, and the 1950 European Convention on Human Right.

¹⁹ Neni 56, Kompetenca për Caktimin e qendrave të votimit, Ligji për “Zgjedhjen e Deputetëve” (2022).

Raporti i organizatës CRTA²⁰, ngrinte mjaft problematika për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të dhjetorit 2023, si organizimi dhe transporti me autobusë në kryeqytet i votuesve nga jashtë për të votuar për partinë në pushtet. Këto pretendime minuan besimin e publikut në integritetin e zgjedhjeve lokale dhe gjithashtu ndikuan në pranimin e rezultateve parlamentare. Po ashtu, kjo organizatë u akuza si nga ana e autoriteteve ashtu dhe mediave pro-qeveritare për prishje të rendit kushtetues të vendit.²¹



Grafik nr.1: Përqindja e votuesve të regjistruar nga jashtë ndër vite (2023- 32,216; 2022 - 39,777; 2022 (referendum) – 1,766; 2020 - 13.251; 2017 - 9.984; 2016 – 6,649)²²

Edhe pse e drejta për të votuar nga jashtë për shtetasit serbë është parashikuar për herë të parë në vitin 2000, duke u përfshirë në ligjin për “Zgjedhjen e Deputetëve” duke ju mundësuar në këtë mënyrë të drejtën politike për të votuar shtetasve serbë që jetonin jashtë vendit në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, pjesëmarrja e votuesve nga jashtë ka qenë e ulët.²³ Siç duket qartë dhe në grafik, pjesëmarrja e diasporës në zgjedhje është relativisht e ulët, duke qenë në vlerën 0.5 % të totalit të votuesve për vitin 2023.²⁴ Në Raportin e CRTA dhe Komisionit Evropian për Serbinë 2024 përmendet pjesëmarrja e diasporës në zgjedhjet parlamentare të dhjetorit 2023, ku sipas këtij raporti për të mundësuar votën e qytetarëve që jetojnë jashtë, u hapën 81 vendvotime në 35 vende të ndryshme të botës.²⁵ Megjithatë, pjesëmarrja mbeti e ulët për shkak të proceseve burokratike

²⁰ Center for Research, Transparency and Accountability.

²¹ https://www.osce.org/files/f/documents/1/3/563505_0.pdf, fq. 26.

²² <https://cрта.rs/en/final-election-observation-report-2023/>.

²³ [Serbian Elections After 2000: One Step Forward, Two Back | ISPI](https://www.ispi.org/serbian-elections-after-2000-one-step-forward-two-back).

²⁴ 6,500,666 votues nga të cilët 32,210 i përkisnin diasporës.

²⁵ CRTA: Final election observation report 2023 fq. 63.

për regjistrimin dhe kërkesat për të votuar personalisht në misionet diplomatike dhe konsullore të Serbisë.²⁶

Lidhur me votimin e diasporës së shtetit serb vihen re një sërë kufizimesh dhe sfidash si:

- Procesi i regjistrimit burokratik dhe aplikim paraprak.
- Distanca e madhe deri tek ambasadat dhe numri i kufizuar i vendvotimeve, gjë që sjell pengesa në pjesëmarrje.
- Mungesa e transparencës në regjistrimin e votuesve jashtë vendit.
- Shitblerja e votës.

4.2 Votimi i Diasporës në Kosovë

Nga viti 2001 Kosova ka mbajtur 9 zgjedhje parlamentare,²⁷ të cilat kanë ndodhur përgjatë kushteve të ndryshme politike dhe shoqërore. Tre nga to janë zhvilluar përpara shpalljes së pavarësisë dhe gjashtë zgjedhje të përgjithshme janë zhvilluar pas shpalljes së pavarësisë.²⁸ Zgjedhjet e para parlamentare pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës u mbajtën më 12 dhjetor 2010, pas votimit të mosbesimit ndaj qeverisë së zgjedhur në 2007. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë,²⁹ në nenin 7 paragrafi 2 të ligjit fillestar, parashikohej votimi i shtetasve që jetonin jashtë Kosovës. Ndërkohë, që vota e diasporës në Kosovë ka nisur nga viti 2009, me zgjedhjet lokale të asaj periudhe dhe më pas është aplikuar për herë të parë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010.

Megjithatë, duhet theksuar se vetëm në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, partitë politike në Kosovë kanë nisur angazhimin e tyre për votat e diasporës,³⁰ dhe po në këtë vit KQZ ka nisur përdorimin e postës elektronike për procedurat e aplikimit dhe njoftimit të votuesve nga jashtë, duke zgjeruar mundësitë dhe përshpejtuar procesin e komunikimit me votuesit. Ndërsa në Zgjedhjet e vitit 2019 dhe 2021 nuk është përdorur fare posta fizike për njoftimin e votuesve jashtë vendit. Ky ndryshim sado i vogël ka pasur efekte pozitive për KQZ-në dhe votuesit, ashtu edhe në aspektin financiar.

Zgjedhjet e 9 shkurtit të vitit 2025, shënojnë një moment historik në historinë demokratike të Kosovës, si zgjedhjet e para të rregullta që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, ku qeveria e Albin Kurtit përfundoi një mandat të plotë katërvjeçar.³¹ Njëherësh në këto zgjedhje shënohet dhe numri më i lartë i votuesve nga diaspora që morën pjesë në procesin zgjedhor në rreth 84,064 persona.

²⁶ https://www.osce.org/files/f/documents/1/3/563505_0.pdf fq. 4.


²⁷ 2001 – 2004 – 2007 – 2010 – 2014 – 2017 – 2019 – 2021 – 2025.

²⁸ [Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë \(2001–2021\): trendet, rezultatet dhe pasojat politike - KoSSev](#).

²⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti Iii / Nr. 31 / 15 qershor 2008. LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.

³⁰ [Vota e diasporës për zgjedhjet parlamentare në Kosovë ndër vite - kosovofacts](#).

³¹ [EDDA EOM Kosovo 2025 - Final Report](#).



Grafik nr. 2 - Numri i votave të vlefshme në secilin vendvotim

Sipas grafikut të mësipërm, numri total i personave që morën pjesë në zgjedhjet e 2025 ishte 966,283 qytetarë, nga të cilat 938,010 kanë rezultuar vota të vlefshme ku, 15,191 vota të vlefshme nga votimi i zhvilluar në përfaqësitë diplomatike dhe 63,025 të tilla të numëruara nga votimi me postë.

Kosova aplikon sistemin proporcional, i cili përdor listat e hapura për zgjedhjen e 120³² deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe lejohet si për zgjedhjet lokale ashtu edhe për ato parlamentare.³³ Në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, u bë i mundur votimi për herë të parë në përfaqësitë diplomatike të Kosovës në 22 shtete, pasi deri më tani votimi në zgjedhjet e kaluara ishte bërë përmes postës. Votimi fizik në këto përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, nuk aplikohet për zgjedhjet lokale.

Rregullat dhe procedurat e votimit jashtë Kosovës parashikohen në kapitullin XIV të Kodit Zgjedhor të Republikës së Kosovës.³⁴ Në nenin 96 paraqiten dispozitat e përgjithshme sipas të cilave, shtetasit që kanë mbushur moshën për të votuar dhe jetojnë jashtë Kosovës, mund të votojnë në zgjedhjet duke aplikuar dhe pasi ky aplikim është aprovuar. Vota dërgohet përmes postës në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë, dhe pranimi nga KQZ-ja bëhet në rast së fleta e votimi përmban vulën e dërgimit para ditës së zgjedhjeve.

Shtetasit kosovarë që jetojnë jashtë, mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit si më poshtë:

- ✓ ‘fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, Kjo mënyrë votimi nuk aplikohet në zgjedhjet lokale;
- ✓ duke dërguar fletëvotimet përmes kutisë postare të KQZ-së;
- ✓ duke dërguar fletëvotimet përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ-ja përmes dhe me lehtësimin e përfaqësive diplomatike, jashtë Kosovës.”³⁵

³² Neni 64, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.


³³ [Factsheet: Diaspora Voting in Kosovo Assembly Elections 2021 – Germin.](#)

³⁴ Nenet 96-98, LIGJI NR. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

³⁵ Neni 96 par 3 LIGJI NR. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Sipas raportit të organizatës Germin,³⁶ në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, për votimin e diasporës u vunë re një sërë problematikash si, mungesa e mjeteve të identifikimit; mungesa e njohurive për të drejtën zgjedhore dhe procedura e ndërlikuar e aplikimit; afate të shkurtra për aplikimin/regjistrimin dhe votimin; trajtimi me seriozitetin jo të duhur për votuesit jashtë vendit; mungesa e informacionit lidhur me fushatën.

Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025,³⁷ referuar raportit paraprak të Bashkimit Evropian, Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë, votuesit jashtë Kosovës janë regjistruar paraprakisht për votimin me postë ose fizikisht në përfaqësitë diplomatike të vendeve ku jetojnë, gjë që është prezantuar në këto zgjedhje. Për votimin jashtë Kosovës, KQZ regjistroi gjithsej 104,924 votues: 20,416 votues për të votuar personalisht dhe 84,508 votues që zgjedhën votimin me postë. Pas regjistrimit, për shkak të numrit të ulët të votuesve në disa vende, si dhe vështirësive logjistike dhe administrative, KQZ-ja anuloi pesë qendra votimi jashtë vendit dhe udhëzoi votuesit që kishin zgjedhur këtë alternativë që të votojnë përmes kutisë postare. Ndërsa, votuesit me të drejtë vote që nuk u regjistruan për votimin jashtë Kosovës ishin pjesë e listave të votuesve dhe mund të votonin në qendrën e votimit të tyre të rregullt, ose në një qendër të caktuar votimi për votim me kusht, të vendosur në secilën komunë.



Grafik nr. 3 - Votues nga diaspora që kanë marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare nga viti 2017 – 2025³⁸

Mund të themi që në zgjedhjet e 2025, është arritur numri më i lartë i votuesve nga jashtë ku totali i atyre që u bënë pjesë e procesit ka qenë 84,064. Duhet theksuar se një aspekt mjaft i mirë i këtyre zgjedhjeve duke zbatuar dhe ndryshimet rekspektive që kanë ndodhur ligj, ka qenë votimi fizik në përfaqësitë diplomatike, i cili ka siguruar që rreth 15,348 qytetarë të mund të votonin pranë këtyre qendrave. Kjo formë votimi siguron transparencë më të lartë të procesit të votimit, duke ofruar kushte të barabarta votimi për qytetarët jashtë vendit si dhe nxit pjesëmarrjen më të lartë në votime dhe siguron fshehtësinë e votës.³⁹

Gjithashtu, dy format e tjera të votimit të parashikuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, janë përmes kutisë postare të KQZ-së dhe përmes postës në një nga kutitë

³⁶ [DiasporaVote_2019.pdf](#), fq. 22.

³⁷ [Preliminary Statement_FINAL.pdf](#).

³⁸ [Vota e diasporës për zgjedhjet parlamentare në Kosovë ndër vite - kosovofacts](#).

³⁹ <https://germin.org/wp-content/uploads/2021/07/Raporti-i-Votes.pdf> fq. 44.

postare të hapura nga KQZ-ja në përfaqësitë diplomatike, jashtë Kosovës. Kjo formë e fundit e votimit, lehtëson kapjen e afateve të shkurtra në dorëzimin e zarfeve të fletëvotimit në kohë. Votat e dërguara në përfaqësitë diplomatike arrijnë më shpejt. Pas kësaj, misioni diplomatik apo konsullor mund t'ia dërgojë me postë diplomatike KQZ-së, duke përsheptuar në këtë mënyrë procesin e votimit.⁴⁰ Forma postare e votimit duke dërguar fletëvotimin pranë përfaqësive diplomatike, ul kostot financiare dhe organizative dhe lehtëson aksesin e votuesve në votime.

4.3 Analiza dhe krahasimi i praktikave

Shqipëria aplikoi për herë të parë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 votën e diasporës, duke përdorur votimin me postë. Kjo formë votimi paraqet disa aspekte pozitive. *Së pari* ka kosto më të ulët financiare (për shtetin) në krahasim me realizimin e votimit fizik, pavarësisht se pagesa për postën këtë vit u bë nga shteti, si për të nxitur votimin për herë të parë ashtu edhe për të lehtësuar shpenzimet e qytetarëve që votojnë nga jashtë, për shkak të kostove të postës. *Së dyti*, është akresi më i shpeshtë përse i përket pikave postare. Nga ana tjetër, votimi përmes postës ndikon në rritjen e fenomenit të votimit familjar, ka transparencë më të ulët duke qenë se mund të ketë dhe ndikime të jashëm të vetë partive politike, shërbimet postare mund të jenë të shtrenjta dhe gjithashtu duhet patur kujdes në respektimin e afateve.

Votimi në misionet diplomatike dhe përfaqësitë konsullore, një praktikë e zbatuar nga Serbia dhe e implementuar për herë të parë nga Kosova në zgjedhjet e shkurtit të vitit 2025, ka rezultuar në një rritje të numrit të votuesve që përdorin këtë formë. Për shumë qytetarë, ky lloj votimi mund të jetë më i lehtë, pasi shmang procedurat burokratike të votimit me postë. Gjithashtu, votimi në misionet diplomatike është më transparent, ul riskun e fenomenit të votimit familjar dhe nxit pjesëmarrje më të lartë. Sidoqoftë, për shtete të mëdha si SHBA, Gjermani, Francë etj., mund të ndikojë në aksesin e qytetarëve për të arritur në këto qendra. Për më tepër, kostoja logjistike dhe organizative e organizimit të votimeve fizike në këto misione diplomatike është më e lartë për shtetin.

Kosova ka implementuar një sistem votimi fizik në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, ose në hapësira të tjera të ngjashme, duke mundësuar dërgimin e fletëvotimeve përmes kutisë postare të KQZ-së, ose duke përdorur kutitë postare të hapura nga KQZ-ja në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike jashtë Kosovës. Kjo mundësi ofron alternativa të ndryshme për qytetarët, duke rritur pjesëmarrjen në zgjedhje dhe duke lehtësuar procedurat burokratike. Për më tepër, kjo praktikë kontribuon në rritjen e transparencës, si dhe zvogëlon mundësinë e fenomenit të votimit familjar dhe ndikimin e mundshëm të përfaqësuesve të partive politike mbi votuesit e diasporës.

5. KONKLUZIONE

Në vitin 2020, diaspora shqiptare përbëhet nga rreth 1.7 milion banorë, nga të cilët një pjesë konsiderueshme janë mbi moshën 18 vjeç dhe kanë të drejtë vote. Duke marrë parasysh këto të dhëna, përllogaritet se rreth 14% e zgjedhësve me të drejtë vote (përkatesisht 238,000 individë) mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar nga jashtë vendit. Ky fakt është një zhvillim pozitiv

⁴⁰ Po aty.

dhe përforcon nevojën për një sistem të qartë dhe efektiv të votimit për diasporën, për të mundësuar pjesëmarrje më të madhe dhe më të barabartë të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit në proceset zgjedhore.

Zhvillimi i procesit të votimit nga diaspora në Shqipëri ka kaluar përmes disa ndryshimeve dhe përmirësimesh ligjore që synojnë rritjen e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së qytetarëve shqiptarë jashtë vendit në zgjedhjet kombëtare. Megjithatë, ka ende disa sfida që ndikojnë në efektivitetin e këtij procesi, të cilat kërkojnë vëmendje dhe përmirësime të mëtejshme, prej të cilave mund të theksohen:

1. E drejta e ankimit gjyqësor për votuesit nga jashtë

Përmirësimi i Procesit të Ankimit dhe Regjistrimit

Ndryshimet e vitit 2025 të Kodit Zgjedhor kanë sjellë përparime të dukshme në mekanizmin e ankimit për zgjedhësit që votojnë nga jashtë. Afati i shkurtuar për paraqitjen e kërkesës për regjistrim mund të duket si një pengesë për disa zgjedhës, por gjithashtu ka mundësuar një proces më të shpejtë dhe më të aksesueshëm.

Platforma Elektronike dhe Aksesueshmëria

Përdorimi i një platforme elektronike për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë nga jashtë është një hap përpara, duke i mundësuar zgjedhësve të paraqesin kërkesat për regjistrim nga distanca. Kjo platformë siguron që kërkesat të shqyrtohen brenda 48 orëve, duke mundësuar reagim të shpejtë nga gjykata dhe rrit mundësitë për pjesëmarrjen në procesin zgjedhor.

Përfitimet e Efektivitetit dhe Shpejtësisë

Pavarësisht afatit të shkurtuar, ky mekanizëm i ri i ankimit siguron që zgjedhësit të marrin vendimet përkatëse në një periudhë të shkurtër. Kjo e bën procesin më të shpejtë, më të besueshëm dhe më të aksesueshëm për ata që jetojnë jashtë Shqipërisë, duke u ofruar mundësinë për të realizuar të drejtën e tyre për të votuar.

2. Komisioni i Posaçëm për Votat nga Jashtë

Dominimi i Dy Partive Kryesore

Struktura e komisionit të posaçëm për votat nga jashtë, e cila parashikon propozim të anëtarëve nga shumica dhe pakica parlamentare, i jep dominim dy partive kryesore. Ky ndarje krijon mundësinë për monopolizim të procesit, duke minuar përfshirjen e palëve të tjera politike.

Përputhshmëria me Rekomandimet Ndërkombëtare

Kjo praktikë bie ndesh me rekomandimet e OSBE/ODIHR për depolitizimin e organeve të administratës zgjedhore. Organet zgjedhore duhet të jenë të paanshme dhe të mbështetura në përfshirjen e të gjitha aktorëve politikë, për të siguruar një proces zgjedhor të drejtë dhe të besueshëm.

Nevoja për Përfshirjen e Aktorëve të Tjerë Politikë

Për të përmbushur standardet ndërkombëtare dhe për të garantuar një proces zgjedhor të drejtë, duhet të sigurohet një përfshirje më e gjerë e aktorëve politikë në komisionin që administron votat

nga jashtë. Përpyekjet për të depolitizuar këtë proces janë thelbësore për besueshmërinë e zgjedhjeve.

3. Afati i Regjistrimit të Zgjedhësve

Mungesa e Harmonizimit të Afateve

Aktualisht, ekziston një mospërputhje mes afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe ato të përcaktuara në aktet rregullatore të Komisionit Rregullator (KQZ). Kodi Zgjedhor përcakton afatin për përfundimin e regjistrimit të zgjedhësve 60 ditë përpara zgjedhjeve, ndërsa aktet rregullatore e kanë përcaktuar këtë afat në 68 ditë para zgjedhjeve, duke krijuar një paqartësi në procesin e regjistrimit.

Koordinimi i Afateve

Për të siguruar një proces të drejtë dhe efikas të regjistrimit të zgjedhësve jashtë vendit, afatet për regjistrimin e listave të zgjedhësve dhe për paraqitjen e kërkesave duhet të jenë të harmonizuara dhe të koordinuara. Kjo do të mundësojë që të gjithë individët që dëshirojnë të regjistrohen të kenë mundësi të aplikojnë brenda një periudhe të përcaktuar dhe që KQZ-ja të ketë kohën e duhur për përpunimin e kërkesave dhe përfshirjen e tyre në listën përfundimtare.

Përputhshmëria me Aktet Ligjore

Për më tepër, është e domosdoshme që aktet nenligjore të mos bien ndesh me dispozitat ligjore. Kur një akt nënligjor parashikon afate të ndryshme nga ato të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, kjo përbën shkelje të rregullave ligjore dhe mund të çojë në pavlefshmërinë e këtij akti.

4. Orari i Votimit dhe Procedurave të Dërgimit të Dokumentacionit Zgjedhor

Përputhshmëria e Orarit të Votimit

Kodi Zgjedhor përcakton një orar të qartë për mbylljen e qendrave të votimit në orën 19:00 të ditës së zgjedhjeve. Megjithatë, Vendimi nr. 13/2024 krijon një "afat të rekomanduar" për dërgimin e dokumentacionit zgjedhor, i cili mund të çojë në paqartësi lidhur me përputhshmërinë e orarit të mbylljes së qendrave të votimit dhe afatit për dërgimin e dokumenteve zgjedhore.

Mungesa e Saktësisë në Vendim

Vendimi nr. 13/2024 nuk sqaron plotësisht procedurat e lidhura me orarin e dërgimit të dokumentacionit zgjedhor, duke lënë hapësirë për vonesa dhe pasaktësi në procesin zgjedhor. Kjo mungesë saktësimi mund të ndikojë negativisht në integritetin e procesit zgjedhor, duke krijuar mundësi për mos përputhje të orarit dhe komplikime të tjera logjistike.

5. Paqartësi ligjore në kuadër të terminologjisë, procedurave dhe dokumentacionit zgjedhor

Pasaktësi në Terminologjinë dhe Procedurat Zgjedhore

Ka pasaktësi ligjore lidhur me terminologjinë dhe procedurat e përdorura për "kutinë rezervë për votimin nga jashtë" në aktet ligjore të ndryshme, duke krijuar paqartësi mbi funksionin dhe rolin e këtyre kutive në procesin zgjedhor. Kjo paqartësi u sqarua me kalimin e kohës, por ajo thekson nevojën për një përcaktim të qartë dhe të saktë të këtyre termave që lidhen me procesin e votimit nga jashtë.

Konflikti midis Vendimeve të Ndryshme

Ka një paqartësi në trajtimin e dokumentacionit zgjedhor të depozituar pas orës 19:00 të ditës së zgjedhjeve. Ndërsa Vendimi nr. 13/2024 parashikon që dokumentacioni i dërguar pas këtij afati të regjistrohet dhe depozitohet në një kuti rezervë, Vendimi nr. 22/2025 specifikon një trajtim të ndryshëm për dokumentacionin që mbërrin pas mbylljes së kutisë së votimit, deri në orën 19:00. Kjo pasaktësi midis dy vendimeve kërkon harmonizimin e procedurave për të siguruar një administrim të qartë dhe të besueshëm të dokumentacionit zgjedhor dhe për të ruajtur integritetin e procesit zgjedhor.

6. REKOMANDIME

Në kuadër të analizës dhe gjetjeve të mësipërme, dalim në rekomandimet e mëposhtme:

- 1) *Së pari*, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të ankimit gjyqësor për votuesit nga jashtë, rekomandohet që afatet të harmonizohen më tej me proceset administrative dhe të sigurohet më shumë kohë për zgjedhësit për të regjistruar kërkesat e tyre, pa pasur frikë nga vonesat e mundshme. Po ashtu, duhet të shtohet një sistem mbështetjeje dhe informacioni më të gjerë për diasporën në mënyrë që të inkurajohet pjesëmarrja e zgjedhësve dhe të sigurohet transparenca e plotë në çdo hap të procesit zgjedhor.
- 2) *Së dyti* është e nevojshme të merren masa për të rishikuar strukturat e komisionit të votave nga jashtë, duke garantuar një përfaqësim më të gjerë dhe të balancuar të partive politike. Përmirësimi i transparencës dhe përfshirja e partive të tjera politike në administrimin e procesit zgjedhor është kyç për forcimin e besimit të qytetarëve në proceset zgjedhore.
- 3) *Së treti*, për të siguruar një koordinim dhe harmoni mes dispozitave ligjore dhe nenligjore, është e nevojshme që aktet rregullatore të KQZ të ndryshojnë për të përputhur afatet e regjistrimit me ato të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Kjo do të mundësojë një proces më të qartë dhe të paqartë për qytetarët dhe për KQZ.
- 4) *Së katërti*, për të siguruar një proces zgjedhor të saktë dhe të paanshëm, është e nevojshme që të ketë një harmonizim të plotë midis orarit të mbylljes së qendrave të votimit dhe afatit për dërgimin e dokumentacionit zgjedhor. Kjo do të mundësojë një proces më të qartë, më efikas dhe pa kontradikta që mund të dëmtojnë besueshmërinë e zgjedhjeve.
- 5) *Së pesti*, për të siguruar një proces zgjedhor të saktë dhe të besueshëm, është e nevojshme që të gjithë aktorët e përfshirë të kenë një kuptim të qartë të termave dhe procedurave që lidhen me kutitë e votimit nga jashtë dhe dokumentacionin zgjedhor. Kjo do të zvogëlonte mundësitë për pasaktësi dhe do të mundësonte një administrim më të efektshëm të procesit zgjedhor, duke ruajtur integritetin dhe transparencën.
- 6) *Së gjashti*, për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, të konsiderohet mundësia e votimit në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet përditësimeve dhe ndryshimeve legjislative.
- 7) *Së shtati*, institucionet ligjzbatuese dhe Kuvendi, duhet të investohen në përpjekje për të ngritur diskutime të frytshme institucionale & legjislative mbi modus operandi-n më produktiv të procesit të votimit të diasporës, i cili do të garantonte respektimin e fshehtësisë së votës së diasporës.
- 8) *Së teti*, në mënyrë që të sigurohet një zbatim i drejtë i parimit së sigurisë juridike, rekomandohet harmonizimi i termave, koncepteve, procedurave dhe aspekteve të tjera të rregulluara nga aktet nënligjore të votimit të diasporës.